



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 39 Prot

Tiranë, më 25.1.2021

Nr. 368 Dosje

URDHËR



Lënda: Dërgohet urdhër për vënien e sekuestros konservative

Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT (QKB) - TIRANË

Unë, Lorina Kollaku, me detyren e Përbaruesit Gjyqësor pranë zyrës së Përbarimit "T.M.A" SHPK, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. (82-2019-1566) 139 Vendimi, të lëshuar me datë 25.07.2019 prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës, jam caktuar të ve në ekzekutim këtë urdhër sipas kërkesës së kreditorit "Autoriteti Kombëtar i Ushqimit" ndaj debitorit "Albanian Network Food Industry" shpk në lidhje me titullin ekzekutiv "Proces Verbal Inspektimi dhe Vendimi Perfundimtar Nr. AKU-El-2018-001197-2 datë 21.11.2018.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin Nr. 514Prot., Datë 12.10.2020 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban titulli ekzekutiv, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA Se:

Debitori nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajm.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të fillojë ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kredite, pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme te debitorit në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit

.Përsa më sipër, në referim të neneve 36,37, të Ligjit Nr. 26/2019 "Për Shërbimin Përbarimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ

1. Qendra Kombëtare e Biznesit, të vendose masen e sekuestros konservative mbi kuotat e subjektit, si dhe mbi te drejtat që rrjedhin nga zoterimi i këtyre kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar për :



- Shoqëria "Albanian Network Food Industry" – NUIS L72622202, adresa Lagjja Shenkoll, rruga Thoma Kalefi, zona kadastrale 8522, objekti me numer pasurie 16/474, Elbasan
- 2. Për informimin, bllokimin dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorët e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.

Lidhur sa me sipër, duke konsideruar këte urdher të plote dhe konform kërkesave të ligjit, ju bëj me dije se:

- a) Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
- b) Kunder detyrimit që percakton ky urdher, i cili është një veprim procedural përmbarimor i referuar në Kodi i Procedurës Civile, palet mund të paraqesin ankim para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 5 (pese) dite, nga dita e marrjes njoftim të këtij urdhri.
- c) Ky urdhër mbahet në 5 (pese) kopje.

ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "T.M.A"

Përmbaruesi GJYQËSOR

Lorina KOLLAKU

